



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 26 Shkurt

Nr: 6

VENDIM

PËR MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021.

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 26 .02.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

**BAZA LIGJORE:** Neni 20, paragrafi 1, shkronja “g”, nenit 97 paragrafi 1 dhe 98 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja “a” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VEREN

Referuar nenit 12, pika 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori)



Data: 26 Shkurt 2021  
Nr. 6

Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Referuar nenit 20, pika 1, shkronja “g”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për rregullat dhe furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor.

Referuar nenit 97, paragrafi 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për zgjedhjet për Kuvendin, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore dhe sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind.

Referuar nenit 98, paragrafi 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KQZ-së.

Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elemente teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë (barkod). Elementet e sigurisë dhe elementet teknike janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr.1 e cila së bashku me modelin janë pjesë integrale e këtij vendimi.

### PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 20, paragrafi 1, shkronja “g”, nenin 97, paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 98 paragrafi 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



Data: 26 Shkurt 2021  
Nr. 6

Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë  
të datës 25 prill 2021.

### VENDOSI:

1. Miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisioni Rregullator, mund të ndryshojë përmasat e fletës së votimit, në varësi të listave shumëmemërore për cdo zonë zgjedhore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana**      **NANO -**

**Kryetare**

**Arens**      **ÇELA -**

**Anëtar**

**Dritan**      **ÇAKA -**

**Anëtar**

**Helga**      **VUKAJ -**

**Anëtare**

**Muharrem**      **ÇAKAJ -**

**Anëtar**



**Specifikimet teknike të fletës së votimit**  
**Për Zgjedhjet për Kuvendin, 25.04.2021**

---

**Lloji i letrës:**

Watermark 90gr/m<sup>2</sup> 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikate origjine, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime, element në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Zarfi me elementët e sigurisë dorëzohet i vulosur nga operatori ekonomik dhe depozitohet në KQZ.

**Dimensionet e fletës së votimit:**

Gjerësia e fletës së votimit	297 mm
Gjatësia e fletës së votimit	420 mm

**Specifikime të përgjithshme:**

Stema e Republikës, me ngjyra,

Logo KQZ, me ngjyra,

Barkodi (elemente teknik ne formen e kodeve):

- |                              |          |
|------------------------------|----------|
| • Numri serial               | 7 shifra |
| • Qarku                      | 2 shifra |
| • Numri i qendrës së votimit | 5 shifra |

